VENDIM
Nr.6, datë 16.2.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Alfred Karamuço	Anëtar	i	Gjykatës Kushtetuese
Kristofor Peçi	Anëtar	i	“ “
Kujtim Puto	Anëtar	i	“ “
Vjollca Meçaj	Anëtare	e	“ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“ “
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“ “
Sokol Sadushi,	Anëtar	i	“ “

me sekretare Brunilda Bara, në datën 7.12.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.45/15 Akti që i përket:

KËRKUES: ASAMBLEJA E BANORËVE TË PALLATIT NR.10, TIRANË, përfaqësuar nga avokatët Mirjana Hoxha e Selfo Dosti, me prokurë.

SUBJEKTE TE INTERESUARA:

1. DOROTEA ZOTO, përfaqësuar nga avokatet Liljana Ruli e Evelina Qirjako, me prokurë.

2. AVOKATURA E PËRGJITHSHME E SHTETIT, përfaqësuar nga avokati i shtetit, Abaz Deda, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.11, datë 11.2.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesit, kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të sipërm:

- Nuk iu është komunikuar kërkesa për rishikim dhe se, në shqyrtimin e kësaj kërkese, nuk janë thirrur nga gjykata;
- Subjekti i interesuar, Dorotea Zoto, nuk ka paraqitur provë të re që të vlente për rishikimin e vendimit.

Subjekti i interesuar, ka parashtruar:

- Çështja nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për rishikim, nuk është vendim përfundimtar e për pasojë, kërkuesve nuk iu kanë shterrur mjetet, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës;
- Pretendimet e kërkuesve për rishikimin janë ezauruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku po zhvillohet gjykimi.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Midis kërkuesve, Asamblesë së Banorëve të Pallatit nr.10, Tiranë dhe subjektit të interesuar, Dorotea Zoto, si trashëgimtare e të ndjerit Guljelm Luka, është zhvilluar proces gjyqësor lidhur me një banesë, të cilën Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tiranë, nuk ia ka kthyer Dorotea Zotos e trashëgimtarëve të tjerë, por është privatizuar në favor të kërkuesve.

Dorotea Zoto, ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, shpalljen si të pavlefshme të kontratave të shitjes së apartamenteve kërkuesve, si dhe detyrimin e tyre për të njohur Dorotea Zoton etj., si pronarë.

Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.5851, datë 10.11.1997, ka rrëzuar kërkesën. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.956, datë 2.6.1998. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.54, datë 5.2.1999, nuk ka kaluar për shqyrtim

gjyqësor rekursin e paraqitur nga Dorotea Zoto.

Dorotea Zoto, ka paraqitur pranë Gjykatës së Lartë, kërkesë për rishikim të vendimeve të mësipërme duke paraqitur disa dokumente, të cilat sipas saj, nuk ishin administruar në gjykimet e mëparshme.

Kërkuesit nuk kanë ardhur në dijeni për këtë kërkesë dhe as për faktin se ajo u shqyrtua nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pa pjesëmarrjen e palëve. Në përfundim, Gjykata e Lartë, me vendimin nr.11, datë 11.2.2005, ka vendosur pranimin e kërkesës për rishikim dhe prishjen e vendimeve nr.5851, datë 10.11.1997 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.956, datë 18.11.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.54, datë 5.2.1999 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjykata Kushtetuese konstaton se ky vendim është rezultat i një procesi të parregullt gjyqësor, duke cenuar nenin 42/1 të Kushtetutës. Në një sërë vendimesh të Gjykatës Kushtetuese është pranuar se shqyrtimi i kërkesave për rishikim, në rastet kur ajo gjendet e bazuar, duhet realizuar duke zbatuar disa standarde siç janë: vënia në dijeni e subjekteve të interesuara për kërkesën e paraqitur, sigurimi i pjesëmarrjes së palëve në shqyrtim, garantimi i "barazisë së armëve" me qëllim që secilës palë t'i sigurohen mundësitë përkatëse që të parashtrojë argumentet e veta në gjendje të përshtatshme, etj.

Në rastin në shqyrtim, kërkuesit kanë ardhur në dijeni të prishjes së vendimeve të formës së prerë e të rishqyrtimit të çështjes vetëm kur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dërgoi lajmërimet për gjykim. Atyre nuk u është krijuar nga Gjykata e Lartë asnjë lloj mundësie që nëpërmjet pjesëmarrjes gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikim, të parashtronin, në kushte të barabarta me palën tjetër prapësimet e tyre si dhe t'u garantohej mbrojtja e duhur ligjore.

Gjykata Kushtetuese gjithashtu nëpërmjet jurisprudencës së saj, i ka dhënë zgjidhje edhe problemit që u ngrit si pretendim nga subjekti i interesuar lidhur me moslegjitimimin e kërkuesve për shkak të mosezaurimit të mjeteve të tjera të mbrojtjes ligjore, duke iu referuar nenit 131, shkronja "f" të Kushtetutës. Lidhur me një problem të tillë, Gjykata Kushtetuese është shprehur se "... në këto raste, edhe pse çështja kthehet për rigjykim dhe procesi gjyqësor vazhdon, në aspektin e shterrimit të mjeteve, ka rëndësi fakti se kërkuesi nuk ka mjet tjetër ankimi ndaj shkeljeve të pretenduara në instancën e fundit të gjykimit dhe se shqyrtimi gjyqësor rishtazi, nuk pretendon t'i ndreqë këto shkaqe, por të gjykojë çështjen në themel".[1]

Përsa i përket pretendimit tjetër të kërkuesve sipas të cilit, Dorotea Zoto nuk ka paraqitur në gjykatë dokumente të cilat sipas ligjit përbëjnë shkak për rishikim, Gjykata Kushtetuese nuk e merr në shqyrtim, sepse ai përbën një shkak që është tej kompetencave të saj për kontrollin kushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.11, datë 11.2.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë;
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

[1] Vendimi nr.17, datë 18.7.2005 i Gjykatës Kushtetuese